




*Universiteti i Shkodrës
“Luigj Gurakuqi”*



Shkodër, 2011

PASQYRA E LËNDËS

Kreu I:	Dispozita të përgjithshme	3
Kreu II:	Organizimi i USH	4
Kreu III:	Drejtimi dhe administrimi i USH.....	6
Kreu IV:	Autoritetet drejtuese.....	12
Kreu V:	Organizimi i studimeve	17
Kreu VI:	Kërkimi shkencor	18
Kreu VII:	Personeli	19
Kreu VIII:	Autonomia financiare.....	22
Kreu IX:	Studentët.....	23
Kreu X:	Ceremonitë	24
Kreu XI:	Emri, Vula zyrtare dhe Stema	
Kreu XII:	Rishikimi i statutit	
Kreu XIII:	Dispozita kalimtare dhe të fundit.....	

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Hartimi dhe përmbajtja

1. Ky statut është hartuar në zbatim të nenit 39 të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 "*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*" (i ndryshuar) dhe është zbatim konkret i këtij ligji, si dhe gjithë legjislacionit tjetër në fuqi për Arsimin e lartë.
2. Statuti pasqyron riorganizimin e strukturimit të brendshëm të U.SH-së dhe të programeve të studimit në bazë të nenit 83 të ligjit sipërcituar.
3. Statuti përmban normat kryesore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit, si organizimin, veprimtarinë dhe punën e strukturave përbërëse, të autoriteteve dhe të organeve drejtuese, zgjedhjen ose përzgjedhjen e tyre, nivelet e delegimit të autoritetit nga organet drejtuese dhe administruese, periudhën e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave dhe të programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, joakademik dhe të studentëve, si dhe detyra të tjera që rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Mbi bazën e këtij Statuti dhe të udhëzimeve të ndryshme përgatiten rregulloret e brendshme të njëjësive kryesore të U.SH.-së dhe të organeve apo autoriteteve që janë në juridiksionin e tij.

Neni 2

Pozita juridike

1. Universiteti i Shkodrës «*Luigj Gurakuqi*» është Institucion publik i Arsimit të Lartë (IAL) i RSH, i njohur me ligj si i tillë. Veprimtaria e Universitetit bazohet në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, në Ligjin nr. 9741, datë 21. 5. 2007 "*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*" (i ndryshuar), në këtë Statut dhe në rregulloret që miratohen, në zbatim të tyre. Universiteti i Shkodrës është person juridik publik dhe përfaqësohet nga Rektori.
2. Universiteti i Shkodrës u themelua me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.167, datë 28 Maj 1991. Ai u ngrit mbi bazën e Institutit të Lartë Pedagogjik të hapur me 2 Shtator 1957, që festohet si datë e krijimit të Universitetit të Shkodrës.
3. Selia qendrore e Universitetit të Shkodrës është Rektorati, me adresë : Sheshi "2 Prilli", Shkodër, ndërsa njësitë e tjera të Universitetit kanë selitë e tyre, të cilat përcaktohen në rregulloret respektive.
4. Stema dhe vula e Universitetit të Shkodrës janë sipas anekseve bashkëlidhur këtij Statuti.

Neni 3

Misioni

1. Universiteti i Shkodrës (shkurt USH) ka si mision të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe shërbimeve. Gjithashtu ai ka si mision edhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj.
2. USH ka për detyrë të japë njohuri bazë me metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet të caktuar profesioneve dhe specialitetesh sipas fushave që mbulon, si dhe të sigurojë arsimim dhe kualifikim të mëtejshëm profesional e shkencor.

3. USH ushtron funksionet themelore të kërkimit shkencor dhe të didaktikës për çdo tip formimi të nivelit të lartë, duke përfshirë orientimin, formimin e përhershëm dhe përditësimin kulturor e profesional, veprimtaritë bazë apo plotësuese për to, si dhe kërkimin e aplikuar për problemet me interes publik apo privat.
4. USH ka për detyrë të plotësojë standartet për të garantuar zhvillimin mësimor e atë shkencor në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, me synimin që në të ardhmen të ofrojë programin e ciklit të tretë të studimit.
5. USH ka për detyrë të ndihmojë dhe të mbështesë zhvillimin kulturor e ekonomik në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Ai promovon, organizon dhe kryen shërbime kulturore dhe formuese në territorin e qarkut të Shkodrës, në të gjithë vendin, si dhe jashtë tij.

Neni 4

Autonomia

1. USH ka autonomi e cila shprehet në :
 - a. Zgjedhjen e organeve dhe autoriteteve të veta drejtuese;
 - b. Organizimin e strukturave të tij të brendshme dhe të veprimtarisë së tyre në përputhje me dispozitat ligjore, Statutin dhe rregulloret e hartuara në zbatim të tyre.
 - c. Në përcaktimin e fushave të mësimdhënies e të kërkimit shkencor ;
 - d. Të drejtën për hartimin e programeve të studimit dhe të projekteve të kërkimit
 - e. Në përzgjedhjen e personelit të vet akademik dhe administrativ ;
 - f. Të drejtën e caktimit të kriterëve të pranimit të studentëve në programet e studimeve ;
 - g. Të drejtën për të lidhur marrëveshje me Universitete e shkolla të larta të vendit e të huaja, si dhe me institucione të tjera, për shkëmbim përvoja, për trajnime, për kualifikimin e personelit ose për kërkime shkencore në fusha me interes të përbashkët ;
 - h. Të drejtën e anëtarësimit në shoqata kombëtare apo ndërkombëtare që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë ;
 - i. Të drejtën për të mbledhur fonde dhe për të përfituar mjete materiale sipas rregullave ligjore në fuqi
 - j. Të drejtën për të realizuar marrëveshje të pavarura me qeverinë, institucione, shoqëri biznesi ose organizata të tjerë, vendase ose të huaja, publike ose private.
 - k. Të drejtën për të administruar pasuritë e dhëna nga shteti ose donatorë të ndryshëm, si dhe fondet publike dhe të ardhura të tjera që zotërojnë, sipas mënyrës së parashikuar në ligj.

Neni 5

Liria akademike

1. USH ka liri akademike në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor.
2. Liria akademike qëndron në respektimin e opinionëve, të ideve, metodave dhe në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.

Neni 6

Paprekshmëria

1. USH gëzon paprekshmëri, e cila garantohet nga shteti.
2. Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset e USH bëhet vetëm me kërkesën ose lejen e Rektorit.

3. Lejohet ndërhyrja e organeve të rendit publik pa lejen e Rektorit vetëm në rastet e kryerjes së një krimi flagrant dhe në rastet e një fatkeqësie natyrore. Pas ndërhyrjes, këto organe janë të detyruara të njoftojnë menjëherë Rektorin.
4. Për çdo cënim të paprekshmërisë së USH-së Rektori kërkon ndëshkim sipas dispozitave ligjore.

KREU II

ORGANIZIMI I USH-së

Neni 7

Njësitë përbërëse të USH-së

1. Veprimtaria e USH-së organizohet e realizohet me njësitë përbërëse dhe drejtohet e kontrollon nga organet drejtuese që veprojnë me kompetenca të përcaktuara sipas ligjit nr. 9741 dt 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe këtij statuti .
2. Universiteti i Shkodrës përbëhet nga
 1. njësi organizative kryesore,
 2. njësi organizative bazë,
 3. njësi organizative ndihmëse
3. Secila nga këto njësi ka strukturën e saj, si dhe ka autonomi (në nxjerrjen e akteve të veta normative), vetëveprimi dhe financiare, sipas përcaktimeve në këtë Statut dhe në rregulloren e USH.

Neni 8

Njësi organizative kryesore.

1. Njësitë organizative kryesore janë fakultetet e institutet.
2. Fakulteti dhe instituti janë njësi kryesore që bashkërendojnë mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore – kërkimore të përafërta apo të ndërthurura.
3. Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve e të niveleve të ndryshme, në përfundim të të cilave përfitohet diplomë.
4. Secila njësi kryesore e U.SH-së miraton rregulloren e tij bazuar në Ligjin nr. 9741, datë 21. 5. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) dhe në këtë statut .

Neni 9

Njësitë organizative bazë

1. Njësitë organizative bazë janë:
 - Departamentet;
 - Qendrat kërkimore-shkencore
2. Departamenti është njësi bazë mësimore-kërkimore në USH që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore respektive.
 - 2.1. Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, artistike ose sportive, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit.
 - 2.2. Departamenti ka të drejtë të organizohet në grupe mësimore dhe/ose kërkimore.

- 2.3.Fusha e kërkimit shkencor, disiplinat mësimore dhe struktura organizative e secilit departament përcaktohen në rregulloren e fakultetit.
- 2.4.Titullarët e grupeve duhet të kenë, së paku gradën doktor dhe përzgjidhen me konkurim të hapur, të drejtuar nga një komision “ad-hoc”, i ngritur nga këshilli i profesorëve.Titullari i njësisë bazë i propozon autoritetit drejtues të njësisë kryesore emërimin e kandidatit të renditur në vendin e parë të listës nga komisioni ad-hoc, për një periudhë 4 vjeçare.
3. Qendrat e kërkimit dhe të zhvillimit janë njësi bazë të kërkimit dhe zhvillimit në USH, fushat e kërkimit të cilave harmonizohen me interesat e departamenteve të fakultetit. Ato përfshijnë fusha kërkimi homogjene.
- 3.1.Qendrat e kërkimit dhe të zhvillimit nxisin, bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtaritë me karakter kërkimor – shkencor në fushat që ata mbulojnë
- 3.2.Qendrat e kërkimit dhe të zhvillimit marrin pjesë në realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë .
- 3.3.Stuktura organizative e qendrave të kërkimit dhe të zhvillimit është e ngjashme me atë të departamentit.

Neni 10 *Njësitë ndihmëse*

1. Njësi ndihmëse janë:
 - a. njësitë organizative administrative;
 - b. laboratorët;
 - c. biblioteka/t;
 - d. qendrat e tjera administrative e teknike.
2. Funksionimi dhe administrimi i njësive ndihmëse përcaktohet në rregullore të veçanta.
3. Njësitë ndihmëse përcaktohen në strukturën organizative të USH.
4. Drejtuesit e njësive emërohen nga Rektori, duke u bazuar në “*Rregulloren për zënien dhe ruajtjen e vendit të punës*”.
5. Funksionimi dhe administrimi i njësive ndihmëse përcaktohet në rregullore të veçanta.

KREU III

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I USH-së

Neni 11 *Organet drejtuese dhe administruese të USH-së*

1. Organe drejtuese dhe administruese të USH-së janë :
 - a. Senati akademik;
 - b. Rektori;
 - c. Këshilli i administrimit;
 - d. Këshilli i Etikës;
 - e. Këshilli i Fakultetit.
2. USH ka të drejtë të propozojë pranë strukturave përkatëse edhe formimin e organeve të reja drejtuese në përputhje me misionin dhe veprimtarinë e tij.

Neni 12
Senati akademik

1. Senati akademik është organ kolegjal vendimmarrës i USH-së, i cili përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor, si dhe vlerëson efikasitetin e tyre.
2. Kryetar i Senatit akademik është Rektori.
3. Senati akademik mbledhet periodikisht, si rregull, 1 herë në muaj.
4. Senati akademik përbëhet nga 21 përfaqësues, nga Rektori dhe 20 përfaqësues të zgjedhur me votim të fshehtë nga personeli akademik efektiv (gjithsej 16: Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Shkencave të Edukimit dhe Fakulteti i gjuhëve të huaja përfaqësohen me nga 2 anëtarë të stafit akademik në Senat; kurse Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës përfaqësohen me nga 4 anëtarë të stafit të tyre akademik), personeli joakademik (1 përfaqësues) dhe nga studentët (3 përfaqësues), të zgjedhur sipas procedurave të përcaktuara në "Rregulloren e zgjedhjeve të USH".
5. Senati akademik ka këto funksione kryesore :
 - a. garanton respektimin e parimeve të autonomisë dhe të mundësive të barabarta të lirisë akademike e të kërkimit shkencor, si dhe të drejtat e studentëve;
 - b. miraton planin disavjeçar të zhvillimit të USH dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;
 - c. vendos me shumicën e votave të anëtarëve të tij projekt-buxhetin e USH, pasi merr miratimin nga Këshilli i administrimit;
 - d. miraton ndarjen e burimeve financiare;
 - e. miraton projekt-statutin e USH me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij;
 - f. vlerëson dhe miraton programet e reja të studimit, të kërkimit dhe të zhvillimit;
 - g. vlerëson dhe miraton hapjen, ndryshimin ose mbylljen e njësisë mësimore ose kërkimore - shkencore;
 - h. vlerëson, garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në USH në përputhje me standardet shtetërore;
 - i. vlerëson veprimtarinë mësimore-kërkimore të personelit akademik;
 - j. siguron që kryerja dhe vlerësimi i të gjitha provimeve të bëhet në përputhje me standardet e arsimit të lartë, duke garantuar cilësinë dhe transparencën e duhur.
 - k. kërkon mendimin e Këshillit të Administrimit për probleme që janë kompetencë e këtij të fundit.
 - l. i propozon MASH hapjen apo mbylljen e programeve të reja të studimit në USH;
 - m. i propozon MASH kuota dhe kritere të veçanta të pranimeve në USH, si dhe tarifat e regjistrimit,
 - n. përcakton kriteret e pranimit për kandidatë në ciklin e dytë të studimeve, sipas propozimeve të këshillave të fakulteteve, si dhe i propozon MASH kuotat përkatëse;
 - o. miraton në parim marrëveshjet apo kontratat e bashkëpunimit me të tretët, që do të nënshkruajë Rektori, në emër dhe për llogari të USH-së;
 - p. miraton paraprakisht hapjen e filialeve, krijimin e qendrave apo kurseve të posaçme, si dhe projekteve të tjera të shërbimit që ofrohen nga fakultetet, bazuar në propozimin e këshillit të fakultetit përkatës;
 - q. miraton rregulloren e brendshme të tij;

- r. miraton rregulloret e USH-së që janë kompetencë e tij.
 - s. jep titullin “*Profesor emeritus*” anëtarëve të personelit akademik më të sukseshëm, kur arrijnë moshën e pensionit, sipas kriterëve të përcaktuara nga MASH. “*Profesorëve emeritus*” u jepet një mjedis pune në departament dhe një shpërblim mbi pensionin, masa e të cilit përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave.
 - t. jep titullin “*Profesor nderi i Universitetit të Shkodrës*” për personalitete të shquara dhe pedagogë vendas apo të huaj që kanë kontribute të dukshme akademike dhe shkencore, si dhe kanë dhënë e japin ndihmesë të dallueshmë në mbarëvjtjen e punëve në Universitet.
 - u. Miraton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore si dhe atë financiare, në mbledhje të hapur, për të gjithë personelin akademik e administrative dhe për studentët.
6. Nga anëtarët e tij Senati akademik zgjedh nënkryetarin dhe sekretarin e tij, statusi i të cilëve përcaktohet në rregulloren e brendshme të Senatit akademik.
 7. Senati akademik i USH organizohet në komisione të përhershme:
 - a. Komisioni i punës mësimore dhe kurrikulave
 - b. Komisioni i kualifikimeve dhe kërkimit shkencor
 - c. Komisioni i statutit, i rregulloreve dhe i disiplinës
 - d. Komisioni i ekonomisë dhe i burimeve njerëzore
 - e. Komisioni i marrëdhënieve me jashtë
 - f. Komisioni i botimeve
 8. Mandati i anëtarit të Senatit është 4 – vjeçar.
 9. Mandati i anëtarit të Senatit merr fund kur :
 - përbushet afati i mandatit;
 - jep dorëheqjen;
 - largohet nga USH ose humb statusin e studentit
 - bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
 - nuk merr pjesë, për 3 herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjet e Senatit akademik.
 - Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas “*Rregullores së zgjedhjeve*”.
 10. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Senatit akademik, pjesëmarrja, votimi, shumica për marrjen e vendimeve dhe çështje të tjera të lidhura me to parashikohen në rregulloren e brendshme të Senatit akademik të USH-së .

Neni 13 **Rektorati**

1. Rektorati është organ kolegjal ekzekutiv, që përbëhet nga:
 - a. rektori;
 - b. zëvendësrektor/ët;
 - c. dekanët;
 - d. kancelari.
2. Rektorati kryesohet nga Rektori
3. Funkcionet kryesore të Rektoratit janë:

- a. hartimi i planit disavjeçar të zhvillimit të USH;
 - b. hartimi i programit vjetor të veprimtarive dhe ndjekja e zbatimit të tij pas miratimit në Senatin akademik;
 - c. formulimi i kriterëve për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
 - d. parashtrimi i përparësive mes kërkesave konkurruese për financime nga njësitë kryesore të USH-së;
 - e. hartimi dhe propozimi për miratim në Senatin akademik i projektbuxhetit të USH-së;
 - f. hartimi i planit të investimeve, i kontratave dhe i marrëveshjeve, që janë kompetencë e tij;
 - g. paraqitja e rekomandimeve për projektet e programeve të studimit, të kërkimit shkencor dhe të ndryshimeve të nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
 - h. zbatimi i të gjitha vendimeve të miratuara nga Senati akademik dhe Këshilli i administrimit;
 - i. monitorimi dhe publikimi i rezultateve të vlerësimit të veprimtarive të USH;
 - j. përgatitja e marrëveshjes për rregullat e financimit ndërmjet USH dhe Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës;
 - k. propozimi i strukturës së përgjithshme dhe i numrit të personelit të USH për të gjitha nivelet;
 - l. përgatitja e rregullores së tij të brendshme e cila miratohet nga Senati akademik.
 - m. ushtrimi i kontroleve tematike të programeve dhe planeve mësimore të fakulteteve dhe departamenteve, si dhe të planeve vjetore e mujore përkatëse në njësitë e USH-së për përmbushjen e qëllimeve të tij, si dhe për zbatimin e akteve të organeve të Universitetit.
4. Rektorati kërkon mendimin e Senatit akademik dhe të Këshillit të administrimit për aspekte të kompetencës së këtyre të fundit
 5. Rektorati kërkon mendimin e Senatit akademik dhe të Këshillit të administrimit për aspekte të kompetencës së këtyre të fundit.
 6. Rektorati harton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe ia paraqet atë për miratim Senatit akademik brenda muajit shtator të çdo viti.
 7. Rektorati harton planin vjetor të veprimtarisë kërkimore - shkencore dhe ia paraqet atë për miratim Senatit Akademik brenda dates 20 dhjetor të çdo viti.
 8. Rektorati harton raportin vjetor të veprimtarisë financiare dhe ia paraqet atë për miratim Këshillit të administrimit brenda datës 20 dhjetor të çdo viti.

Neni 14

Këshilli i administrimit

1. Këshilli i administrimit është organ kolegjal vendimmarrës, që mbikëqyr e kontrollon veprimtaritë e USH-së, që lidhen me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të pronave të tij.
2. Funkcionet kryesore të Këshillit të Administrimit janë:
 - a. miraton kriteret për ndarjen e burimeve financiare;
 - b. miraton me kërkesën e Senatit akademik projektbuxhetin e USH-së me dy të tretat e votave;
 - c. vlerëson efikasitetin e përdorimit të fondeve nga buxheti i shtetit ose burime të tjera të ligjshme dhe publikon rezultatet e vlerësimit;
 - d. miraton strukturën dhe numrin e personelit të USH-së për të gjitha nivelet;
 - e. miraton raportin vjetor financiar të paraqitur nga Rektorati;

- f. vlerëson planin e zhvillimit të USH-së dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;
 - g. miraton rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin;
 - h. miraton rregulloren e brendshme të tij;
 - i. miraton paraprakisht tarifën e regjistrimit në USH dhe ia përcjell për miratim të mëtejshëm Senatit akademik;
 - j. i propozon MASH kriteret për përcaktimin e nivelit të pagave të punonjësve mësimorë dhe jo mësimorë, si dhe tarifën e orës mësimore;
 - k. informon Senatit akademik për situatën financiare dhe projektet përkatëse për të gjithë Universitetin.
6. Këshilli i administrimit përbëhet 13 anëtarë nga:
 - a. 6 anëtarë të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë, nga një për cdo njësi kryesore të USH-së, nga stafi akademik efektiv me gradë shkencore;
 - b. 6 anëtarë të caktuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, përfaqësues nga fushat e shkencës, të ekonomisë, të kulturës, autoritete të pushtetit qendror dhe atij vendor;
 - c. një anëtar, përfaqësues i zgjedhur nga këshilli i studentëve të USH.
 7. Anëtarët, sipas shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, caktohen dhe shkarkohen nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës. Numri i anëtarëve të caktuar është një më pak se numri i anëtarëve nga personeli akademik e studenti i zgjedhur të këshillit të administrimit. Këshilli i administrimit zgjedh kryetarin, prej anëtarëve të brendshëm të personelit akademik të tij, me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve.
 8. Anëtarësia në Këshillin e administrimit është e papajtueshme me detyrën e anëtarit të Senatit akademik, të zëvendësrektorit/ëve, të dekanëve, të zv/dekanëve dhe të drejtorëve të qendrës së kërkimit dhe zhvillimit.
 9. Mandati i anëtarit të Këshillit të administrimit është 4-vjeçar.
 10. Mandati i anëtarit të Këshillit të administrimit mbaron kur:
 - përmbushet afati i mandatit;
 - jep dorëheqjen;
 - largohet nga USH, për ata që janë të caktuar sipas pikës 3, shkronjat "a" dhe "c", të këtij neni;
 - bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrijë funksionin;
 - kur nuk merr pjesë, për 3 herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme, në mbledhjet e Këshillit të administrimit;
 - Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
 11. Rektori dhe kancelari i institucionit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të administrimit, pa të drejtë vote, kur e vlerësojnë ata vetë, si dhe kur thirren nga ky Këshill.
 12. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Këshillit të Administrimit, pjesëmarrja, shumica për marrjen e vendimeve dhe çështjet e tjera të lidhura me to, parashikohen në rregulloren e brendshme të Këshillit të administrimit të USH. Mbledhja e parë për konstituimin e Këshillit të Administrimit thirret nga Rektori i USH-së dhe drejtohet nga anëtari i brendshëm i personelit akademik me moshën më të madhe.
 13. Rektori i USH-së siguron infrastrukturën administrative për zhvillimin e mbledhjeve dhe ruajtjen e dokumentacionit të Këshillit të Administrimit.

Neni 15

Këshilli i fakultetit

1. Këshilli i fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës që programon e përcakton në bazë të propozimeve të departamenteve përdorimin e burimeve njerëzore e materiale në dispozicion të fakultetit.
2. Këshilli i fakultetit kryesohet nga dekani.
3. Këshilli i fakultetit ka këto kompetenca:
 - a. Shqyrton dhe miraton kërkesat e departamentit për programe të reja studimi dhe ia propozon Senatit Akademik për shqyrtim dhe miratim të mëtejshëm;
 - b. shqyrton dhe miraton kërkesat e departamentit për hapje, ndryshim ose mbyllje departamentesh ose njësisish të tjera dhe ia propozon Senatit Akademik për shqyrtim dhe miratim të mëtejshëm;
 - c. merr vendime për problemet financiare të fakultetit, në përputhje me autoritetin që i është deleguar atij;
 - d. shqyrton dhe miraton raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore, kërkimore e shkencor në mbledhje të hapura për personelit akademik, administrative dhe studentët.
 - e. i propozon Senatit akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikëqyr realizimin e tij;
 - f. miraton rregulloren e fakultetit;
 - g. miraton në parim marrëveshjet që synon të lidhë fakulteti i tyre me të tretë, përpara se të nënshkruhen nga dekani; me autorizim të rektorit.
4. Në ushtrimin e kompetencave të tij Këshilli i fakultetit shprehet me vendime.
5. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Këshillit të fakultetit, pjesëmarrja, shumica për marrjen e vendimeve dhe çështjet e tjera të lidhura me to, parashikohen në rregulloren e brendshme të Këshillit të fakultetit.

Neni 16

Këshilli i etikës

1. Këshilli i etikës i USH është organ kolegjal, i cili diskuton për probleme të etikës së jetës universitare. Ai i bën propozime rektorit për këto çështje.
2. Anëtarët e Këshillit të etikës përzgjidhen nga Senati akademik, nga personeli akademik (si rregull, me titullin apo gradën më të lartë), sipas propozimeve të Rektorit.
3. Këshilli i etikës përbëhet nga 5 anëtarë dhe kryesohet nga Rektori. Këshilli duhet të ketë në përbërjen e tij një jurist.
4. Në mbledhjen e parë të tij, Këshilli i etikës miraton rregulloren e etikës së universitetit.
5. Mënyra e shqyrtimit të ankesave, vendimet, sanksionet përkatëse dhe ekzekutimi i këtyre vendimeve, parashikohen në rregulloren e etikës të USH -së.
6. Këshilla të etikës mund të ngrihen edhe pranë fakulteteve.

Neni 17

Këshilli i Profesorëve

1. Këshilli i profesorëve është organ kolegjal, për organizimin, drejtimin dhe ndjekjen e kualifikimit shkencor e pedagogjik në USH.
2. Anëtarë të këshillit të profesorëve janë të gjithë anëtarët e personelit akademik që kanë titullin "Profesor".

3. Numri minimal i anëtarëve KP duhet të jetë shtatë vetë. Në rast se numri i "Profesorëve" është më i vogël se shtatë, për të arritur këtë numër në KP mund të jenë anëtarë edhe personeli akademik me titull "Profesor i asociuar".
4. Veprimtaria e Këshillit të profesorëve rregullohet me rregullore të vecantë.

KREU IV

AUTORITETET DREJTUESE

Neni 18

Autoritetet drejtuese të USH

1. Autoritete drejtuese të USH janë :
 - a. Rektori
 - b. Dekani
 - c. Përgjegjësi i njësisë bazë / Qendrës së kërkimit dhe të zhvillimit
2. Autoritete të tjera të U.S.H-së janë :
 - a. Zëvendësrektori/ët
 - b. Zëvendësdekani/ët
 - c. Kancelari.

Neni 19

Rektori

1. Rektori është autoriteti më i lartë drejtues i USH-së, i cili e përfaqëson atë dhe vepron në emër dhe për llogari të tij.
2. Rektori zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik, personeli joakademik dhe studentët e USH. Ai emërohet nga Presidenti i Republikës.
3. Rektori duhet të ketë të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe me një përvojë akademike pune në këto universitete.
4. Rektori ka mandat 4-vjeçar.
5. Rektori ka këto detyra dhe kompetenca :
 - a. drejton dhe kontrollon veprimtarinë e të gjitha strukturave të USH. Siguron unitetin e USH dhe është garant i autonomisë universitare brenda USH.
 - b. përfaqëson Universitetin e Shkodrës në marrëdhënie me të tretët,
 - c. ka të drejtë të shfuqizojë vendimet e dekanit dhe të Këshillit të fakultetit kur ato bien ndesh me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, me këtë Statut, me rregulloret e USH dhe me vendimet e Senatit të tij. Në raste të konflikteve midis tyre problemi zgjidhet në bazë të nenit 64 të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
 - d. garanton zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të Statutit dhe të rregulloreve të brendshme të USH;
 - e. mund t'i propozojë për probleme të ndryshme që janë në kompetencë të tyre Senatit Akademik, Këshillit të Administrimit apo Këshillit të Etikës;
 - f. nënshkruan në emër të USH marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete të tjera homologe, nënshkruan protokollin e anëtarësimit të këtij Universiteti në shoqata e organizata kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë ose të tjera, nënshkruan dokumentacionin e bashkëpunimit me organizata joqeveritare e donatorë vendas apo të huaj që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë;

- g. cakton delegacionet dhe miraton planet e kualifikimit dhe të specializimit jashtë shtetit të mësimdhënësve, kërkuesve dhe të personelit administrativ;
 - h. është përgjegjës për mbarëvajtjen e proceve të konkurimit për pranimin e personelit akademik dhe joakademik dhe i miraton ato;
 - i. Emëron personelin e ri mësimor – shkencor dhe atë administrativo – teknik të USH-së sipas kriterëve ligjore dhe nënligjore të përcaktuar në këtë Statut dhe në “Rregulloren për zënien dhe ruajtjen e vendit të punës në USH”. Nënshkruan kontratat e punës me personelin e brendshëm dhe të jashtëm USH.
 - j. lëshon diplomat e përfundimit të studimeve në cikle të ndryshme pa pasur të drejtën e delegimit të firmës personave të tjerë.
 - k. emëron kryetarët e degëve, specialistët e lartë dhe personelin tjetër në USH, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore të përcaktuara në këtë Statut dhe në “Rregulloren për zënien dhe ruajtjen e vendit të punës në USH”.
 - l. miraton personelin mësimor e atë shkencor, i cili, për vitin akademik, do të ketë ngarkesë më të ulët nga norma mësimore, duke përcaktuar këtë ngarkesë;
 - m. miraton modelin e kontratës që nënshkruan me personelin shkencor;
 - n. miraton planin kalendarik të procesit mësimor për çdo vit akademik në bazë të udhëzimeve të MASH.
 - o. në raste të cënimit të paprekshmërisë së USH, Rektori ka për detyrë të denoncojë shkeljet sipas dispozitave ligjore në fuqi.
 - p. në rast të konstatimit të shkeljeve flagrante dhe të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga Dekani i Fakultetit, Rektori urdhëron pezullimin e tij dhe i propozon Ministrin të Arsimit dhe Shkencës shkarkimin e tij, i cili shprehet brenda një muaji. Pas shkarkimit Rektori organizon zgjedhjet e parakohshme
 - q. Rektori ushtron të drejtën e marrjes së masave administrative dhe disiplinore (sipas rregulloreve të miratuara dhe të akteve ligjore e nënligjore) ndaj personelit (deri në lirim nga detyra) dhe studentëve (deri në përjashtimin nga shkolla).
 - r. Funkzioni i Rektorit është i papajtuëshëm me funksionet e përgjegjësve të strukturave të USH, si dhe të kryetarit të komisionit të diplomës dhe të provimit të formimit.
6. Rektori emëron dhe shkarkon zëvendësrektorin/ët, pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në senatin akademik.
 7. Në mungesë Rektori delegon kompetenca zëvendësit/ve të tij.
 8. Mandati i Rektorit mbaron kur:
 - a. përfundon afati i mandatit;
 - b. jep dorëheqjen;
 - c. bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrorë funksionin;
 - d. kur shkarkohet sipas nenit 64 pika 3 e Ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - e. dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale
 9. Rektori në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhëra dhe udhëzime

Neni 20

Dekani

1. Dekani është autoriteti drejtues i fakultetit dhe përfaqësuesi ligjor i tij.
2. Dekani zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik, personeli joakademik dhe studentët e USH dhe emërohet nga Rektori.

3. Dekani duhet të ketë të paktën titullin “*Profesor i asociuar*” ose gradën shkencore “*Doktor*” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe me një përvojë akademike në këto universitete.
4. Dekani ka mandat 4 vjeçar.
5. Dekani ka këto detyra dhe kompetenca :
 - a. Ka të drejtë t’i paraqesë propozime për probleme të ndryshme Këshillit të Fakultetit;
 - b. Informon para këshillit të fakultetit për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fakultet;
 - c. miraton planin kalendarik të procesit mësimor për çdo vit akademik në bazë të udhëzimeve të Rektoratit;
 - d. ndjek plotësimin korrekt të dokumentacionit shkollor;
 - e. i propozon këshillit të fakultetit me kërkesë te departamentit hapjen, mbylljen, reformimin e programeve të studimit, të departamenteve apo të njësive të veçanta në fakultet;
 - f. i propozon këshillit të fakultetit hapjen e qendrave kërkimore dhe të zhvillimit, të programeve të ndryshme të studimeve, ofrimin e shërbimeve të ndryshme për të tretët, pjesëmarrjen në projekte brenda apo jashtë vendi.
 - g. Organizon dhe mbikëqyr cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor, të zbatimit të kontratave të punës dhe të çdo detyrimi tjetër të marrë përsipër nga departamentet apo personeli i fakultetit.
 - h. ka të drejtë të shfuqizojë vendimet e përgjegjësit të departamentit kur ato bien ndesh me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, me këtë Statut, me rregulloret e USH dhe me vendimet e Senatit e të Këshillit të fakultetit të tij. Në raste të konflikteve midis tyre problemi zgjidhet në bazë të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 “*Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.
 - i. me autorizimin e Rektorit ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me fakultete e institucione homologe të vendit e të huaja;
 - j. emëron përgjegjësit e zgjedhur të departamenteve;
 - k. drejton dhe kontrollon konkurset e pranimit të punonjësve akademikë e joakademikë në fakultetin e tij;
 - l. propozon masa administrative dhe disiplinore sipas rregulloreve të miratuara dhe të akteve ligjore e nënligjore ndaj personelit deri në lirim nga detyra dhe studentëve deri në përjashtimin nga shkolla.
6. Mandati i Dekanit mbaron kur:
 - a. përfundon afati i mandatit;
 - b. jep dorëheqjen;
 - c. bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
 - d. kur shkarkohet sipas nenit 64 pika 4 e Ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 “*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar;
 - e. dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
7. Në rastin e pezullimit të dekanit, Rektori komandon një anëtar të personelit akademik të brendshëm me kualifikimin e duhur I cili nuk do të konkurojë në zgjedhje.
8. Rektori thërret zgjedhjet e parakohshme për dekanin e ri në përputhje me Ligjin nr.9741, datë 21.05.2007 “*Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë*” I ndryshuar, dhe rregulloren “*Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë për periudhën 2007-2011*”.
9. Dekani në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhëra dhe udhëzime.

10. Marrëdhëniet e Dekanit me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij, parashikohen në rregulloren përkatëse.

Neni 21

Përgjegjësi i njësisë bazë /Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit

1. Përgjegjësi i njësisë bazë /Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit është autoriteti drejtues i Departamentit/Qendrës.
2. Përgjegjësi i i njësisë bazë /Qendrës zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik/kërkimor i brendshëm i Departamentit/Qendrës dhe emërohet nga Dekani.
3. Përgjegjësi i i njësisë bazë duhet të ketë të paktën gradën shkencore “Doktor”, kurse Përgjegjësi i Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit duhet të ketë të paktën titullin “Profesor i asociuar”.
4. Përgjegjësi i njësisë bazë /Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit ka mandat 4 vjeçar.
5. Përgjegjësi i njësisë bazë ka këto detyra dhe kompetenca :
 - a. përgatit planin vjetor dhe planet mujore të veprimtarisë së departamentit të tij dhe i paraqet për miratim te Dekani;
 - b. përgatit propozimet për vendimmarrje të Departamentit;
 - c. përgjigjet para dekanit e Këshillit të fakultetit për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në Departament;
 - d. ndjek plotësimin korrekt të dokumentacionit shkollor për departamentin të cilin drejton
 - e. drejton punën për hartimin e planeve dhe programeve mësimore të lëndëve që mbulon Departamenti dhe ndjek zbatimin e tyre;
 - f. përgatit shpërndarjen e ngarkesës mësimore që miratohet në Departament;
 - g. cakton komisionet e provimeve të lëndëve;
 - h. ushtron kontrole për cilësinë e mësimdhënies;
 - i. cakton dhe deiton pjesë në komisionet për pranimin e punonjësve akademikë në departamentin e tij;
 - j. i propozon dekanit masa administrative dhe disiplinore sipas rregulloreve të miratuara dhe të akteve ligjore e nënligjore ndaj personelit të departamentit të tij deri në lirim nga detyra dhe studentëve deri në përjashtimin nga shkolla.
6. Përgjegjësi i Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit ka këto detyra dhe kompetenca :
 - i. përgatit planin vjetor dhe planet mujore të veprimtarisë së qendrës së tij dhe i paraqet për miratim te Dekani;
 - ii. ndjek zbatimin e planeve shkencore
 - iii. ngre dhe merr pjesë në komisionet për pranimin e punonjësve akademikë në Qëndrën tij;
 - iv. përgjigjet para dekanit e Këshillit të fakultetit për mbarëvajtjen e procesit të kërkimit dhe zhvillimit në Qendër;
7. Mandati i Përgjegjësit të njësisë bazë /Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit mbaron kur:
 - përfundon afati i mandatit;
 - jep dorëheqjen;
 - bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
 - kur shkarkohet sipas nenit 64 pika 5 të ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”;
 - dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

8. Në rastin e pezullimit të Përgjegjësit të njësisë bazë /Qendrës, Dekani komandon një anëtar të personelit akademik të brendshëm me kualifikimin e duhur i cili nuk do të konkurojë në zgjedhje
9. Dekani thërret zgjedhjet e parakohshme për përgjegjësin e ri në përputhje me nenin 21 të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucione publike të arsimit të lartë për periudhën 2007-2011”.
10. Përgjegjësi i njësisë bazë /Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhëra dhe udhëzime.
11. Marrëdhëniet e Përgjegjësit të njësisë bazë Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij, parashikohen në rregulloren përkatëse të Universitetit.

Neni 22

Zëvendësrektori

1. Zëvendësrektori është autoritet që ushtron veprimtari drejtuese në USH.
2. Zëvendësrektori/ët emërohen dhe shkarkohen nga Rektori i USH-së, pas miratimit me mbi 50 % të votave të të gjithë anëtarëve të Senatit akademik të kandidaturës së propozuar prej tij në Senatin akademik.
3. Zëvendësrektori/ët duhet të kenë të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe me një përvojë akademike në këto universitete.
4. Zëvendësrektori, në mungesë të rektorit, siguron drejtimin e punëve në USH, sipas përcaktimeve të këtij Statuti apo detyrave të lëna nga Rektori, si dhe në mungesë dhe me porosi të tij, nënshkruan aktet përkatëse.
5. Zëvendësrektori ka këto detyra dhe kompetenca:
 - a. harton planin kalendarik të procesit mësimor pas propozimeve nga dekanët e fakulteteve.
 - b. ndjek punën mësimore, punën shkencore në USH dhe ngarkesën e personelit mësimor-shkencor të tij.
 - c. ndjek hartimin e zbatimin e planeve e programeve mësimore në fakultete për të gjitha ciklet e studimit.
 - d. organizon e ndjek punën e kualifikimit e të specializimit pasuniversitar, të shkollave e të kurseve pasuniversitare dhe procesin e doktoraturave.
 - e. drejton e kontrollon punën për pranimin e studentëve të rinj në USH.
 - f. ka në varësi dhe kontrollon veprimtarinë e Degës Mësimore – Shkencore.
 - g. organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë në USH, në fakultete dhe në departamente.
6. Zëvendësrektori largohet nga detyra kur:
 - përfundon afati i mandatit;
 - jep dorëheqjen;
 - bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
 - shkarkohet nga Rektori sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 23

Zëvendësdekani

1. Zëvendësdekani është autoritet që ushtron veprimtari drejtuese në fakultet.
2. Zëvendësdekani emërohet dhe shkarkohet nga Rektori i USH-së, pas propozimit të Këshillit të fakultetit.
3. Zëvendësdekani duhet të ketë titullin “Profesor i asociuar” ose gradën shkencore “Doktor”
4. Siguron drejtimin e punëve në Fakultet, sipas përcaktimeve të këtij Statuti apo detyrave të lëna nga dekani, si dhe në mungesë dhe me porosi të tij, nënshkruan aktet përkatëse.
5. Zëvendësdekani ka këto detyra dhe kompetenca:
 - a. harton planin kalendarik të procesit mësimor pas propozimeve nga drejtori/et e departamentit
 - b. ndjek punën mësimore, punën shkencore në fakultet dhe ngarkesën e personelit mësimor-shkencor të tij.
 - c. ndjek hartimin e zbatimin e planeve e programeve mësimore në fakultet për të gjitha ciklet e studimit.
 - d. drejton e kontrollon punën për pranimin e studentëve të rinj në USH.
6. Organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë në fakultet dhe në departament.
7. Zëvendësdekani largohet nga detyra kur:
 - jep dorëheqjen;
 - bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrrojë funksionin;
 - shkarkohet nga detyra me propozim të dekanit

Neni 24

Kancelari

1. Kancelari është autoritet, në përbërje të rektoratit të USH-së përgjegjës për drejtimin e përditshëm administrativ dhe financiar të institucionit, për zbatimin e buxhetit, për mbikqyerjen dhe kontrollin e veprimtarive financiare si për zbatimin e ligjshmërisë.
2. Kancelari për përmbushjen e funksionit kryen detyrat e mëposhtme :
 - a. Drejton veprimtarinë e administratës
 - b. Realizon administrimin financiar
 - c. Drejton planifikimin dhe realizimin e investimeve.
 - d. Mbikëqyr të gjitha procedurat e marrjes në punë
 - e. Drejton procedurat e marrjes në punë dhe vlerësimin e performancës së punonjësve të administratës
 - f. Me autorizimin e rektorit, përfaqëson ose bashkëpërfaqëson USH në të gjitha proceset gjyqësore apo zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me palëtr e treta, persona fizikë ose juridikë.
 - g. Është përgjegjës për zbatimin e ligjshmërisë
 - h. Kryeson sekretariatit teknik, që mbështet veprimtarinë e këshillit të administrimit të USH
 - i. Drejton punën për hartimin e projektbuxhetit të USH;
 - j. I paraqet Senatit projektin për detajimin e fondeve buxhetore, si dhe të burimeve të tjera të financimit;
 - k. Është përgjegjës për zbatimin e buxhetit;
 - l. Organizon dhe menaxhon gjithë procesin zgjedhor në USH dhe përgjigjet për mbarëvajtjen e tij;

- m. Organizon veprimtarinë e shërbimeve ndaj të tretëve në USH;
 - n. Përgjigjet për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të Universitetit, me përjashtim të kompetencave ekskluzive të Këshillit të administrimit;
 - o. Paraqet aktet me natyrë ekonomike dhe financiare për miratim në Këshillin e administrimit dhe për mendim paraprak në Senatin akademik (kur është e nevojshme);
 - p. Përfaqëson USH -në, si firmë e parë kur e delegon nga Rektori në marrëdhëniet financiare me Bankën e Shtetit Shqiptar dhe në marrëdhëniet kontraktore me të tretët, brenda përshkrimit të tij të punës.
3. Për përzgjedhje dhe emërimin e kancelarit të USH ndiqen procedurat e mëposhtme :
- a. Këshilli i administrimit të USH miraton kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët.
 - b. USH shpall publikisht, për dy javë kalendarike, vendin e punës dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për kancelar, si dhe shpall fillimin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së kandidatëve, nëse janë paraqitur, së paku, tri kandidatura;
 - c. Këshilli i administrimit të USH harton skemën e vlerësimit të kandidatëve, duke përshkruar me hollësi mënyrën e vlerësimit të kandidatëve, në bazë të ligjit nr. 8549, datë 11. 11. 1999 "*Statusi i nëpunësit civil*". Përveç dosjes mund të parashikojë edhe një intervistë;
 - d. Çdo anëtar i këshillit të administrimit të USH bën vlerësimin, me shkrim, sipas skemës së miratuar, për çdo kandidat, dhe në fund, në bazë të pikëve të grumbulluara, shpallet renditja e kandidatëve;
 - e. Këshilli i administrimit të USH ka të drejtë të përzgjedhë, me votim të fshehtë, njërin nga tre kandidatët, që kanë grumbulluar më shumë pikë . Fitues shpallet kandidati që merr 2/3 e votave të anëtarëve.
 - f. Këshilli i administrimit të USH, pasi bën përzgjedhjen e kandidatëve, shpall publikisht kandidaturën fituese. Kandidatët kanë të drejtë të ankimojnë vendimin e këshillit të administrimit të USH, vetëm për procedurën e vendimmarrjes, brenda tri ditëve nga data e shpalljes. Ankesat depozitohen në zyrën e protokollit të USH. Këshilli i administrimit të USH ka të drejtë të shqyrtojë ankesat, në përputhje me Kodin e procedurave administrative dhe u përgjigjet atyre me shkrim;
 - g. Këshilli i administrimit të USH, pas rishqyrtimit ia dërgon propozimin e vet Rektorit të USH, brenda 2 (dy) ditëve pune.
 - h. Kandidatura për Kancelar të USH përzgjidhet nga Këshilli i administrimit dhe Rektori ia paraqet atë Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës për miratim;
 - i. Rektori, pas përfundimit të procesit të ankimimit, ia përcjell Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës dosjen e kandidatit për kancelar, brenda dy ditëve pune nga data e ardhjes së propozimit, së bashku me vendimin e me relacionin shoqërues të këshillit të administrimit të USH, ku pasqyrohet i plotë edhe qendrimi i pakicës, që ka votuar kundër. Kur Rektori nuk ia dërgon Ministrinë propozimin e këshillit të administrimit të USH për kandidaturën për kancelar brenda afatit të mësipërm, kryetari i këtij këshilli i dërgon Ministrinë vendimin, brenda dy ditëve pune;
 - j. Ministri i Arsimit dhe i Shkencës ka të drejtë të pranojë ose refuzojë kandidaturën e propozuar, brenda 10 ditëve nga data e mbërritjes së propozimit. Në rast refuzimi të kandidaturës, përsëritet e gjithë procedura e përzgjedhjes së kancelarit të USH. Në rast se Ministri refuzon edhe

kandidaturën e propozuar për herën e dytë, ai ka të drejtë të emërojë një kancelar të komanduar, për jo më shumë se një vit. Gjatë kësaj periudhe, këshilli i administrimit të USH përzgjedh një kandidaturë të re, sipas procedurave të mësipërme.

4. Kancelari largohet nga detyra kur:
 - jep dorëheqjen;
 - bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrisë funksionin;
 - kur shkarkohet shkarkohet nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, me nismën e vet, me propozimin e këshillit të administrimit ose të Rektorit të USH. Procedurat që ndiqen nga Këshilli i Administrimit të USH-së për shkarkimin e kancelarit, janë të njëjta me ato të ndjekura për përzgjedhjen e tij.

KREU V

ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 25

Format e studimeve në USH

1. Studimet në USH organizohen në këto forma:
 - a. studime me kohë të plotë;
 - b. studime me kohë të pjesshme;
 - c. studime në distancë.
2. Aplikimi dhe zbatimi i këtyre formave të studimit bëhet me propozim të Senatit akademik të USH dhe miratim të MASH.

Neni 26

Programet e studimit në USH

1. Programet e studimeve i propozohen nga Departamentet e Fakulteteve të USH Këshillit të Fakultetit i cili ia paraqet për miratim Senatit akademik.
2. Rektorati shpall publikisht programet e akredituara të studimeve që ofron, para fillimit të aplikimeve për pranime në të.
3. Programet e studimeve në USH organizohen në ciklin e parë dhe cikli i dytë të studimeve, sipas dispozitës përkatëse të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
 - 3.1.Studimet e ciklit të parë:
 - a) programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme,dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh;
 - b) b) programet e studimeve të ciklit të parë realizohen me 180 kredite europiane (ECTS) (më tej: kredite) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike;
 - c) në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në fushën e arsimimit të kryer.
 - 3.2.Studimet e ciklit të dytë:
 - 3.2.1Programet e studimeve "Master i shkencave"
 - a) programet e studimeve të ciklit të dytë i pajisin të diplomuarit që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor në një fushë, brenda një specialiteti;
 - b) programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite, ku përfshihen

30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;

c) studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare;

ç) në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë lëshohet diplomë universitare "Master i shkencave" në fushën e arsimimit të kryer.

3.3.2. Programet e studimeve "Master profesional":

a) programet e studimeve "Master profesional" u ofrojnë të diplomuarve, me një diplomë universitare së paku "Bachelor", arsimim dhe trajnim të mirëfilltë profesional;

b) programet e studimeve "Master profesional" realizohen me 60-90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik;

c) studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare;

ç) në përfundim të këtyre programeve të studimeve lëshohet diplomë universitare "Master profesional" në fushën e arsimimit e të trajnimit profesional të kryer.

3.3. Studimet e ciklit të tretë:

3.3.1 Programet e studimeve të doktoraturës

a) programet e studimeve të doktoraturës janë programe të studimeve të ciklit të tretë, me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese

b) në studimet e doktoraturës pranohen kandidatë që kanë fituar diplome universitare "Master i shkencave";

c) këto programe të studimeve zgjasin të paktën 3 vite akademike dhe përfshijnë 60 kredite për studime të organizuara teorike. Në bazë të rezultateve të arritura në studimet e organizuara teorike, vendosin kriteret klasifikimi për kandidatët që kanë të drejtë të zhvillojnë projektin kërkimor dhe të përgatisin tezën e doktoraturës. USH përcakton standarte e kriteret kualifikuese për njohjen e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare, si dhe metoda për vlerësimin e nivelit teorik të përgjithshëm të kandidatëve. Kandidatët që nuk arrijnë të përmbushin kriteret e vendosura, nuk klasifikohen për të vazhduar më tej studimet e doktoraturës dhe paisen me një dëshmi, në të cilën jepen modulet e zhvilluara së bashku me kreditet e grumbulluara dhe vlerësimin e tyre.

ç) në përfundim të programeve të studimeve të doktoraturës lëshohet diplomë për gradën shkencore Doktor.

Neni 27

Pranimet në USH

1. Çdo person që ka përfunduar me sukses Maturën Shtetërore, ka të drejtë të kandidojë për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve në USH.
2. Ciklin e parë të studimeve në USH mund ta ndjekin edhe studentë të huaj, bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe.
3. Për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve, USH ka të drejtë të propozojë kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar maturën shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Këto kriteret shqyrtohen dhe vlerësohen nga Ministria e Arsimit, në këshillim me konferencën e rektorëve, e Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës .

4. Kriteret e pranimit për standardet akademike të përzgjedhjes së kandidatëve për t'u pranuar në programet e *ciklit të dytë* të studimeve miratohen nga Senati Akademik.

Neni 28

Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. Personat që kanë përfunduar një program studimi kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi. Në këtë rast kandidatët e përballojnë koston e plotë të studimeve. Studentët e shkëlqyer përjashtohen nga pagesa e koston së plotë të studimeve në rastet e ndjekjes së një programi të dytë studimi
2. Kriteret për t'u pranuar në një program të dytë studimi përcaktohen në "*Rregulloren e studimeve të USH*".

Neni 29

Transferimet

1. USH ofron mundësi për transferime të studentëve midis programeve të të njëjtit cikël brenda USH-së apo Institucioneve të tjera të Arsimit të Lartë, si dhe për transferime nga programet e mëparshme në programe të studimeve të ciklit të parë.
2. Njësia kryesore e U.SH-së që pranon studentin, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë Statut dhe në "*Regulloren e studimeve të USH*", merr vendimin për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara me qëllim vazhdimin e studimeve.

Neni 30

Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave dhe periudhave të studimeve

1. USH njeh dhe ekuivalenton, mbështetur në kërkesat dhe dokumentacionin përkatës të paraqitur nga personat e interesuar, pjesë ose programe të plota studimi ose diploma të marra në Institucione të tjera të vendit ose të huaja, me qëllim vazhdimin e arsimimit në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm.

KREU VI

KËRKIMI SHKENCOR

Neni 31

Financimi i kërkimit shkencor

1. Personeli akademik i brendshëm apo studentët e ciklit të dytë e të tretë kanë të drejtë të aplikojnë pranë Rektoratit, për fonde nga buxheti i USH-së, për kërkimin shkencor.
2. Kriteret për përfitimin e financimeve për çdo vit miratohen nga Senati akademik dhe shpallen në Rektorat, fakultete dhe në faqen përkatëse të internetit.
3. Brenda tremujorit të dytë të çdo viti shpallen fituesit që përfitojnë financim të plotë apo të pjesshëm për kërkimin shkencor.
4. Me përfituesit e këtyre financimeve lidhet një kontratë e posaçme, në të cilën parashikohën të drejtat dhe detyrimet mes tyre dhe USH -së.

Neni 32

Kërkimi shkencor për të tretë

1. Këshilli i fakultetit mund t'i propozojë Senatit akademik që të ofrojë, vetë ose në bashkëpunim me institucionet e tjera publike apo private, kërkim shkencor, shërbime dhe veprimtari të tjera për të tretë, por me kusht që të plotësojë të gjitha detyrimet individuale apo të njësisë përbërëse për kërkim shkencor ndaj USH
2. Kur nga ofrimi i kërkimit shkencor apo shërbimeve për të tretët krijohen të ardhura, ato ndahen mes institucionit që ofron shërbimin dhe personelit të përfshirë në të, sipas përcaktimeve të rregullores së brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin.

KREU VII

PERSONELI I UNIVERSITETIT

Neni 33

Struktura e përgjithshme dhe organika

1. Rektori propozon për miratim në Këshillin e administrimit strukturën e personelit të ndarë në kategori (personel akademik, personel ndihmës mësimor –shkencor dhe personel administrativ) dhe numri i tyre për secilën pjesë përbërëse, bazuar në numrin total të personelit të USH-së, miratuar nga MASH.
2. Struktura dhe numri i personelit të USH-së për të gjitha nivelet miratohet nga Këshilli i Administrimit.

Neni 34

Personeli akademik

1. Personeli akademik në USH ka këto të drejta:
 - a. të ushtrojë funksionin mësimdhënës dhe të kërkimit shkencor në respektim të lirisë akademike;
 - b. të mos pengohet në çfarëdo forme gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;
 - c. të paguhet sipas kualifikimeve shkencore, si dhe për orët shtesë në masën e lejuar nga dispozitat ligjore e nënligjore;
 - d. të përfitojë lejen vjetore të paguar;
 - e. të kryejë kualifikime shkencore, brenda apo jashtë vendit;
 - f. të kryejë detyra të tjera jashtë funksionit bazë, pa shkaktuar konflikt interesi me USH -në.
2. Personeli akademik ka këto detyrime :
 - a. të zbatojë legjislacionin për arsimin e lartë gjatë ushtrimit të detyrës dhe të respektojë rregullat e Kodit të Etikës;
 - b. të kryejë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor ose të aplikuar,
 - c. të kryejë shërbime për zhvillimin e USH dhe të kryejë detyra administrative sipas nevojave të departamentit, fakultetit apo universitetit;
 - d. të zhvillojë konsultime apo këshillime më studentët;
 - e. të përmbushë detyrën e ngarkuar, si: ngarkesën mësimore, kërkimin shkencor, etj, sipas përcaktimeve në kontratën e punës;
3. Personeli akademik në USH, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në :
 - a. **Profesorë.** Në këtë kategori janë anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë së kërkimit shkencor. Ata kanë gradën shkencore “Doktor,, dhe titujt akademikë “Profesor i asociuar,, “Profesor,, “Profesor emeritus,, dhe “Akademik,,;

- b. *Docentë*. Në këtë kategori janë anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë kryesisht veprimtari mësimore. Ata kanë titullin akademik “*Docent*”, ose gradën shkencore “*Doktor*”;
 - c. *Lektorë*. Në këtë kategori janë anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore. Lektorët duhet të kenë diplomë “*Master i Shkencave*” ose ekuivalente me të dhe të përmbushin kriteret që përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Personeli akademik me tituj i USH ka të drejtë që çdo 7 vjet, për periudha kohe deri në një vit, të punojë për përparimin e tij akademik (viti akademik sabbatik). Gjatë kësaj periudhe, personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhëniejeje. Personeli akademik mund të ndjekë gjatë këtij viti edhe kurse specializimi deri tremujore jashtë institucionit. Midis të interesuarit dhe Rektorit të USH-së, nënshkruhet një kontratë e posaçme.

Neni 35

Personeli akademik i ftuar

1. Për të plotësuar nevojat e procesit mësimor Këshillat e fakulteteve, me propozim të departamenteve, ftojnë për veprimtari mësimore e kërkimore personel akademik, sipas kërkesave të vendit të punës, për periudha semestrale ose njëvjeçare të përsëritshme.
2. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar duhet të kombinojë nevojën e njësisë për mësimdhënie apo kërkim shkencor me kualifikimin e tyre.
3. Secili fakultet në rregulloren e tij përcakton kriteret e detajuara për përzgjedhjen e personelit akademik të ftuar.
4. Përgjegjësi i departamentit përkatës i paraqet këshillit të fakultetit numrin e personelit akademik për t’u ftuar dhe ngarkesën e tij mësimore.
5. Dekani i njofton Rektoratit numrin e personelit akademik të ftuar, si dhe kriteret që duhet të plotësojnë ato.
6. Kontrata e punës me personelin akademik të ftuar nënshkruhet nga Rektori, në emër dhe për llogari të USH - së.

Neni 36

Personeli akademik me kontratë

1. USH ka të drejtë të punësojë me kontratë personel akademik, për periudha të shkurtëra kohe, personalitete vendase ku përfshihen studiues, artiste dhe personalitete me kontribut të shquar jashtë vendit apo personalitete të huaja.
2. Këshilli i Fakultetit, i propozon Senatit akademik të miratojë punësimin e personelit akademik me kontratë.
3. Propozimi i dekanit duhet të jetë i argumentuar me nevojën e fakultetit për kontributin e atij personaliteti, me kualifikimet e tij në atë fushë, si dhe me mundësinë për përballimin e shpenzimeve nga të ardhurat e USH.
4. Mund të punësohen me të njëjtën procedurë edhe studentë në procesin e kryerjes së doktoraturës dhe të përgatitjes së disertacionit për për gradën shkencore “*Doktor*”, duke i trajtuar si “*Lektorë*”.
5. Autoritetet drejtuese të njësive kryesore, me propozimin e përgjegjësit të njësisë bazë dhe të titullarit të grupit mësimor-kërkimor për të plotësuar nevojat e USH-së punësojnë personel akademik me kohë të plotë për veprimtari mësimore e kërkimore, për periudha semestrale ose 1 vjeçare të përsëritshme, sipas kërkesave të vendit të punës.

6. Kriteret e punësimit përcaktohen në rregullore të veçantë.
7. Kontrata e punës me këtë personel akademik nënshkruhet nga Rektori, në emër dhe për llogari të USH.

Neni 37

Personeli ndihmës mësues-shkencor dhe administrativ

1. Personeli ndihmës mësues - shkencor, si dhe personeli administrativ ka pozitën juridike që përcaktohet në rregulloren përkatëse të USH dhe në rregulloren e fakultetit përkatës.
2. Të drejtat dhe detyrimet konkrete të tyre përcaktohen në "Rregulloren e zënies dhe ruajtjes së vendit të punës në USH" dhe në kontratën individuale të punës.

Neni 38

Procedura e punësimit

1. Marrja në punë e personelit në USH kryhet me konkurim publik.
2. Për vendet e lira konkurimi shpallet, duke publikuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në "Rregulloren e zënies dhe ruajtjes së vendit të punës në USH".
3. Emërimi i personelit akademik, bëhet nga rektori pasi dekani i fakultetit dorëzon klasifikimin e bërë nga komisioni Ad-Hoc i konkursit publik i krijuar me urdhër të dekanit.
4. Kandidati fitues nënshkruan kontratën e punës Rektori në emër dhe për llogari USH-së, mbështetur në legjislacionin për Arsimin e Lartë dhe Kodin e Punës të RSH-së.
5. Mënyra e zhvillimit të konkurimit, kriteret e unifikuara sipas kategorizimit të funksioneve, afatet përkatëse të komunikimit mes fakultetit dhe Rektoratit, si dhe çështjet e tjera të detajuara të punësimit parashikohen në rregulloren përkatëse të USH - së.

Neni 39

Mbarimi i kontratës së punës

1. Kontrata e punës së personelit përfundon kur:
 - jep dorëheqjen ose largohet me dëshirën e tij;
 - mbush moshën e pensionit të pleqërisë;
 - bëhet i paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar detyrën;
 - merr masën disiplinore të largimit nga detyra.
 - masa disiplinore vjen si dënim plotësues nga një vendim gjyqësor i formës së prerë.

Neni 40

Masat disiplinore

1. Shkeljet konkrete, lloji i masës disiplinore për secilën shkelje dhe institucioni që i jep ato, përcaktohen në rregulloren përkatëse të USH -së.
2. Personeli akademik në rast marrjeje të masës disiplinore të largimit nga detyra ka të drejtë të dëgjohet nga Senati akademik, i cili është organi kompetent për të vendosur lënien në fuqi apo shfuqizimin e asaj mase. Pas kësaj personeli akademik mund të ndjekë shkallët e ankimit administrative dhe gjyqësor sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VIII

AUTONOMIA FINANCIARE

Neni 41

Autonomia financiare

1. USH-së funksionon sipas parimit të autonomisë financiare.
2. Buxheti i Ush-së hartohet sipas njësive shpenzuese dhe autonome në përputhje edhe me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
3. Mënyra e përdorimit të të ardhurave nga USH përcaktohet në rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin.

Neni 42

Hartimi i buxhetit

1. Projektbuxheti i USH-së hartohet nga Rektorati, duke u mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 3-vjeçar dhe në propozimet e ardhura nga strukturat përbërëse të USH-së.
2. Projektbuxheti i USH miratohet nga Senati akademik pasi miratohet prej Këshillit të administrimit.
3. Hartimi i buxhetit bëhet në përputhje me standardet e vendosura nga Ministria e Financave.
4. Projektbuxheti i përcillet Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, i cili brenda 30 ditëve ushtron kontrollin që i takon sipas ligjit në formën e kërkesës së motivuar për rishikim.

Neni 43

Burimet e financimit

1. Burimet e financimit të USH janë :
 - a. transferta nga buxheti i shtetit
 - b. të ardhura të krijuara nga USH
 - c. burime të tjera me destinacion.
2. USH përgatit rregulloren e tij për mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat e USH, në respektim të ligjeve në fuqi.

Neni 44

Kontrolli dhe auditimi

1. USH i nënshtrohet auditit financiar (të brendshëm e të jashtëm), që realizohet nga institucionet e parashikuara me ligj.
2. Rektorati përfshin në strukturën e tij një njësi të auditit të brendshëm financiar, e cila funksionon në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në USH dhe në njësitë përbërëse të tij, realizohet nga audit i brendshëm i USH dhe njësitë e auditit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
4. Rezultatet e kontrollit dhe auditit bëhen publike.

KREU IX
MARRËDHËNIET ME JASHTË

Neni 45

Marrëdhëniet me jashtë

1. USH ka të drejtën e vendosjes së marrëdhënieve me universitete e shkolla të tjera të larta të huaja me qëllim vendosjen e lidhjeve të bashkëpunimit dhe shkëmbim të përvojës akademike e shkencore.
2. USH ka të drejtën e anëtarësimit në shoqata e organizata ndërkombëtare të arsimit të lartë. Ai bashkëvepron me organizma joqeveritare të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë.
3. Për këto aktivitete ai informon edhe MASH.

KREU X

VEPRIMTARIA BOTUESE

Neni 46

Veprimtaria botuese e USH

1. USH ka organin e vet periodik shkencor "*Buletinin shkencor*", i cili botohet në katër seri
2. Katër seritë e "*Buletinit shkencor*" drejtohen nga redaksi të veçanta, që miratohen nga Rektori. Rektori është në të njëjtën kohë edhe drejtori i revistës.
3. Me plotësimin e kushteve USH ka të drejtën e krijimit të shtëpisë së vet botuese.

KREU IX

STUDENTËT

Neni 47

Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

1. Cilësia e të qenit student fitohet me regjistrimin në USH dhe mbaron me diplomimin apo çregjistrimin e tij nga USH
2. Studentët gjatë ndjekjes së studimeve në USH kanë të drejta dhe detyra:
 - 2.1 Studentët kanë të drejtë:
 - a. të ndjekin leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tyre;
 - b. të përfaqësohen në organet drejtuese të USH (Këshillat e Fakulteteve, në Këshillin e Administrimit dhe në Senatin Akademik) sipas përqindjeve të caktuara në ligj dhe në këtë Statut;
 - c. të organizohen në shoqata studentore (mbi baza jopolitike, jofetare apo joetnike), duke iu përmbajtur përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatëse;
 - d. të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, si dhe stimuj materialë për rezultate të shkëlqyera;

- e. të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të institucionit;
- f. të përdorin të gjitha instalimet e pajisjet e USH për kryerjen e punës së tyre mësimore sipas programit mësimor dhe rregulloreve përkatëse; në biblioteka, salla kompjuterash, mjedise sportive apo qendra të tjera në shërbim të tyre, si dhe të përfitojnë shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga institucioni;
- g. Të pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik. MASH përcakton kriteret dhe procedurat e përgatitjes dhe të lëshimit të këtij dokumenti.

2.II. Studentët kanë detyrë :

- a. Të respektojnë dhe zbatojnë me rigorozitet statutin e USH, të gjitha rregulloret dhe kodin e etikës, e këtij institucioni;
- b. të marrin pjesë në veprimtaritë akademike të organizuara nga departamenti, fakulteti apo universiteti;
- c. Të paguajnë tarifat e shkollimit dhe të shërbimeve që ofrojnë institucionet;

Neni 48

Vlerësimi moral për studentët

1. Studentët që, në përfundim të studimeve të plota, kanë të gjitha notat dhjeta, fitojnë “Medalje të Arië” me certifikatën përkatëse; ata që kanë jo më pak se 80% të notave dhjeta e pjesën tjetër nënta, fitojnë certifikatën “Student i Shkëlqyer”.
2. Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni në çdo fakultet; për studentët që fitojnë “Medalje të Arië” ose certifikatën “Student i Shkëlqyer”, ceremonia organizohet në shkallë Universiteti dhe dorëzimi i diplomave bëhet personalisht nga Rektori, në prani të përfaqësuesve të Senatit, të profesoratit, të administratës dhe të studentëve.

Neni 49

Këshilli studentor

1. Këshilli studentor është organizim i pavarur studentor në USH, që nuk zhvillon veprimtari politike e ekonomike.
2. Këshilli studentor në USH organizohet në nivel fakulteti dhe universiteti.
3. Këshilli studentor promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të USH, në strukturat mësimore-shkencore dhe të shërbimeve.
4. Këshilli studentor ka të drejtë të shprehë mendime dhe propozime për të gjitha problemet e USH.
5. Këshilli studentor zgjidhet çdo vit nga votat e studentëve dhe mbështeten nga legjislacioni në fuqi.

Neni 50

Regjistri i studentëve

1. USH mban regjistër bazë të studentëve me të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programeve të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj., të formatuara këto sipas standarteve shtetërore.
2. Regjistri i studentëve të plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe të mbahet në ruajtje të përhershme.

3. Çdo studenti në regjistrimin fillestar në USH i jepet një numër unik matricullimi që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose çertifikatës.

KREU X

CEREMONITË

Neni 51

Organizimi i ceremonive

1. Në USH organizohen ceremoni të ndryshme sipas rastit. Ndër ceremonitë e përhershme që zhvillohen në USH janë:
 - a. Përvjetorët e krijimit të USH
 - b. Dorëzimi i titujve e gradëve shkencore;
 - c. Fillimi i vitit akademik
 - d. Dorëzimi i diplomave të studentëve
 - e. Dorëzimi i titullit “*Doktor Honoris Causa*”
 - f. Dorëzimi i titujve “*Profesor emeritus*” dhe “*Profesor nderi*”.
2. Në raste solemne akademike autoritetet drejtuese të USH përdorin veshje ceremoniale.
3. Organizimi dhe zhvillimi i ceremonive bëhet duke ndjekur të gjitha procedurat e protokollit të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

KREU XI

EMRI, VULA ZYRTARE DHE STEMA

Neni 52

1. USH ka emrin e vet zyrtar:
UNIVERSITETI I SHKODRËS “Luigi Gurakuqi”.
2. USH ka vulën e vet zyrtare (Modeli 1 në faqen _____)
3. USH ka për simbol të tijin stemën (Modeli 2 në faqen _____)

KREU XII

RISHIKIMI I STATUTIT

Neni 53

E drejta e rishikimit të statutit

1. Nisma për rishikimin e këtij Statuti mund të ndërmerret nga Rektorati, 5 (pesë) senatorë ose 50 (pesëdhjetë) pedagogë efektivë.
2. Rishikimi i propozuar sipas pikës 1 të këtij neni miratohet nga Senati Akademik i USH me 2/3 (dy të tretat) e votave të anëtarëve të tij.

KREU XIII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 54

Miratimi i rregulloreve

1. Brenda një muaji nga e nesërmeja e miratimit të këtij Statuti nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës apo brenda dy muajsh nga mbarimi i afatit për t'u shprehur Ministri, Senati akademik miraton rregulloret e USH që janë në kompetencë bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në këtë Statut.
2. Rregulloret e tjera si: rregullorja e Senatit, rregulloret e fakulteteve, rregullorja e brendshme e administrimit të financave dhe të kontabilitetit, rregullorja e Rektoratit, rregullorja e Këshillit të administrimit, rregullorja e Këshillit të profesorëve, rregullorja e Këshillit të etikës, etj., miratohen nga organet e përcaktuara në këtë Statut, brenda një muaji nga miratimi i rregulloreve të të USH - së.

Neni 55

Hyrja në fuqi

1. Ky Statut hyn në fuqi me shpalljen e tij nga Rektori i USH të nesërmen e miratimit nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës ose të nesërmen e mbarimit të afatit 2-mujor për t'u shprehur Ministri.
2. Nëse Ministri e kthen këtë Statut për ripunim në Senatin akademik, për vërejtje nga pikëpamja e ligjshmërisë, atëherë brenda 5 ditëve nga kthimi i Statutit, Senati akademik mbledhet për të shqyrtuar dhe miratuar me të njëjtën procedurë ndryshimet e propozuara.
3. Kur Ministri i Arsimit dhe Shkencës nuk ka vërejtje për ligjshmërinë e statutit ose nuk shprehet brenda afatit të përcaktuar në nenin 39 pika 2, të Ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Rektori e shpall atë duke e konsideruar të miratuar.



VULA ZYRTARE E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS
“Luigj Gurakuqi”



Modeli 1

STEMA E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS
“Luigj Gurakuqi”



Modeli 2

Universiteti i Shkodrës
“Luigj Gurakuqi “